

## **Hapet thirrja për aplikime për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Charles, në Çeki, në kuadër të programit Erasmus +, për semestrin e dytë të vitit akademik 2020-2021.**

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Charles, në Çeki, për semestrin e dytë të vitit akademik 2020-2021.

<https://fsv.cuni.cz/en/exchange/life/practical-information>

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve për kërkim të temës së diplomës;

### **Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- Bachelor;
- Master;

### **Kohëzgjatja e bursave për studentët:**

- Bachelor (3 muaj);
- Master (3 muaj).

### **Fushat e studimit:**

- Shkenca Politike;
- Shkenca Sociale;
- Marrëdhënie Ndërkombëtare;
- Studime Europiane;

Për katalogun e kurseve klikoni linkun:

[https://is.cuni.cz/studium/eng/prijimacky/index.php?do=info\\_fakulta&fak=11230](https://is.cuni.cz/studium/eng/prijimacky/index.php?do=info_fakulta&fak=11230)

### **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin mujor (800 EUR në muaj për studentët);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

<b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b> ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	<b>Kompensimi</b>
<b>Midis 100 dhe 499 KM</b>	180 EUR
<b>Midis 500 dhe 1999 KM</b>	275 EUR
<b>Midis 2000 dhe 2999 KM</b>	360 EUR
<b>Midis 3000 dhe 3999 KM</b>	530 EUR
<b>Midis 4000 dhe 7999 KM</b>	820 EUR
<b>8000 KM ose më shumë</b>	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Bachelor:**

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze);
- Listë notash (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B2);
- Letër pranimi paraprak nga universiteti pritës;

Për t'u pajisur me Letër pranimi paraprak mund t'i drejtoheni adresave e-mail: [magda.pektorova@fsv.cuni.cz](mailto:magda.pektorova@fsv.cuni.cz) dhe [internacionalizace.ims@fsv.cuni.cz](mailto:internacionalizace.ims@fsv.cuni.cz)

- Plani i kërkimit për temën e diplomës;
- \*Learning Agreement;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Charles temë kërkimi të njëjtë me atë që do të kryeni në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë kërkimi i temës t'ju njihet kur të ktheheni.*

*Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +. Nëse studenti bën ndryshime të lëndëve gjatë mobilitetit, pjesa During mobility duhet të firmoset nga personi përgjegjës në fakultet dhe më pas nga personi përgjegjës në Rektorat.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:*

[https://unitiredu-my.sharepoint.com/:w:/g/personal/iro\\_unitir\\_edu\\_al/EUXqVeKCHV9Fh4ygJxM9NpYB\\_gCi\\_SjRpmoxLU3bs7Usmg?e=wDFUpI](https://unitiredu-my.sharepoint.com/:w:/g/personal/iro_unitir_edu_al/EUXqVeKCHV9Fh4ygJxM9NpYB_gCi_SjRpmoxLU3bs7Usmg?e=wDFUpI)

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:**

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;

- Vërtetim studenti (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze);
- Listë notash e nivelit Master (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze);
- Listë notash e nivelit Bachelor (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze);
- Diplomë e nivelit Bachelor;
- Letër Motivimi në gjuhën angleze;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B2);
- Letër pranimi paraprak nga universiteti pritës;

Për t'u pajisur me Letër pranimi paraprak mund t'i drejtoheni adresave e-mail: [magda.pektorova@fsv.cuni.cz](mailto:magda.pektorova@fsv.cuni.cz) dhe [internacionalizace.ims@fsv.cuni.cz](mailto:internacionalizace.ims@fsv.cuni.cz)

-Plani i kërkimit për temën e diplomës;

-\*Learning Agreement;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Charles temë kërkimi të njëjtë me atë që do të kryeni në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë kërkimi i temës t'ju njihet kur të ktheheni.*

*Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +. Nëse studenti bën ndryshime të lëndëve gjatë mobilitetit, pjesa During mobility duhet të firmoset nga personi përgjegjës në fakultet dhe më pas nga personi përgjegjës në Rektorat.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:*

[https://unitiredu-my.sharepoint.com/:w:/g/personal/iro\\_unitir\\_edu\\_al/EUXqVeKCHV9Fh4ygJxM9NpYB\\_gCi\\_SjRpmoxLU3bs7Usmg?e=wDFUpI](https://unitiredu-my.sharepoint.com/:w:/g/personal/iro_unitir_edu_al/EUXqVeKCHV9Fh4ygJxM9NpYB_gCi_SjRpmoxLU3bs7Usmg?e=wDFUpI)

Afati për aplikim: 21 Janar 2021.

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!